



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 16-9731/2016
Kaçanik, 29.04.2016

Në bazë të nenit 12, 17(e) të Ligjit Nr.03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare Nr. 28 e datës 4 qershor 2008), lidhur me nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233- Për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare Nr. 85 e datës 9 nëntor 2010), të nenit 6 lidhur me nenin 34.5 e Statutit të Komunës së Kaçanikut, si dhe Rekomandimit të Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë Nr.3644/15, të datës 14.07.2015, i cili vepron në kuadër të MMPH, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29 prill 2016, merr këtë:

V E N D I M
PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS GURI I GJATË NË STAGOVË
SI MONUMENT I NATYRËS

1. Me këtë Vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës **Guri të gjatë** në fshatin Stagovë si monument i natyrës i karakterit gjeomorfologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

1.1. Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të zonës buferike prej 5m. përfshinë sipërfaqen prej **3 ari**.

1.2. Monumenti i Natyrës, është monument natyror gjeomonument me karakter gjeomorfologjik. Gjatësia e gurit është 17m, lartësia 11m. Shkëmbi është i dalur mbi sipërfaqe të tokës si masiv i veçantë. Monumenti i natyrës i takon shkëmbinjëve sedimentar.

2. Monumenti i Natyrës gjendet në fshatin Stagovë, pikërisht Krivanjeva, komuna e Kaçanikut, në pronën private të Adem, Elmaz dhe Sahide Krivanjeva, në Zonën Kadastrale Stagovë, në lartësi mbidetare 728m, koordinatat **LAT:42.259685, LONG:21.259998**, në parcelën nr. 1584-0, me sipërfaqe 9500m², me kulturë arë e klasit 5 dhe 6.

3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III – të, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohej:

4.1.1. Dëmtimi, shkatërrimi, bartja e shtresimeve të mineraleve ose fosileve, gjetjet arkeologjike, fosileve dhe gjetjeve tjera, ndryshimi i formës,

4.1.2. Për të gjitha aktivitetet në Monumentin e Natyrës duhet të merret leja nga Ministria e veçanërisht për: I. Kryerja e hulumtimeve shkencore dhe profesionale,

4.1.3. Vendimi për leje përmban edhe kushtet për mbrojtjen e natyrës.

4.2. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

4.2.1. Të gjitha masat e mbrojtjes së Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

5. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohet:

5.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera,

5.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike,

5.3. Ndërrimi i kulturës,

5.4. Mbijella e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mundën me ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

5.4.1. Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

6. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Kaçanikut.

6.1. Kujdestari është i detyruar:

6.1.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes,

6.1.2. Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mundën ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,

6.1.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

7. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

8. Ky Vendim pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

9. Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi i mëhershëm 01. Nr. 16-30576/15, i datës 29.09.2015.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

